



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e dytë të rregullt e Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: 25.02.2021 (e enjte) duke filluar në ora 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-se;
2. Raport mbi dëmet e shkaktuara nga vërshimet gjatë muajit janar 2021 (komisioni për vlerësimin e dëmeve);
3. Aktivitetet rreth luftimit të pandemisë Covid 19;
4. Raport nga OJQ, përfituese të mjeteve për ndihmë qytetarëve, për shkak të pandemisë Covid 19;
5. Raporti i komisionit për të gjeturat e Auditorëve të jashtëm për vitin 2019;
6. Raporti i Kryetarit për vitin 2020;
7. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 16.02.2021
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

H. Arsic



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 28.01.2021, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Predrag Stojkovic, Ivica Cenic, Dragana Dimic, Negovan Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Xhejlane Behluli, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Nënkryetari i Komunës Sinisa Dimic, Drejtori i Urbanizmit Bojan Peric, Drejtori i Bujqësisë Savko Savic, Drejtori i Administratës Driton Abdyli, përfaqësuesi i OSBE-së dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 13 antarë të Kuvendit nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raporti i Kryesuesit për punën e Kuvendit për vitin kalendarik 2020;
3. Aprovimi i planit të punës së Kuvendit dhe orarit të mbajtjes së mbledhjeve për vitin 2021;
4. Pruarja e vendimit për shitjen e automjeteve të vjetëra dhe të zhvlerësuar të Komunës së Novobërdës;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Aprovohet rendi i ditës nga antarët prezent të Kuvendit me 11 vota për, 1 përmbajtur dhe 1 nuk ka votuar.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali nga antarët prezent të Kuvendit me 11 vota për, 1 përmbajtur dhe 1 nuk ka votuar.

Selatin Nuhiu tha: ndoshta është duhur të vij edhe procesverbali nga mbledhja e kaluar e jashtzakonshme që është mbajtur, atë procesverbal nuk e kemi marrë.

Kryesusi tha: mbledhja e kaluar ka qenë e rregulltë, ndërsa procesverbalin e mbledhjes se jashtzakonshme e kemi aprovu në mbledhjen e kaluar.

Pika e dytë: Raporti i Kryesuesit për punën e Kuvendit për vitin kalendarik 2019;

Kryesuesi tha: të gjithë e dini se vitin 2020 jemi ballafaqur dhe po ballafaqohemi ende me pandemin covid-19 dhe për arsye të këtij viruesi nuk kemi pasur mundësi që ti mbajm të gjitha mbledhjet e planifikuara. Por përseri kemi arritur që pikat e rëndësishme të diskutohen në Kuvend dhe të marrim vendime. Kuvendi Komunal ka mbajtur 8 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Të gjitha

mbledhjet janë mbajtur në bazë të planit vjetor të punës. Në mbledhjet e rregullta dhe jashtëzakonshme të mbajtura kemi aprovuar: 17 vendime të gjitha janë verifikuar nga ana e Ministrisë kompetente për vetqeverisje lokale. Kuvendi përveç mbledhjeve të rregullta të Kuvendit ka mbajtur edhe mbledhje të rregullta të Komitetit për Politik dhe Financa ku për këtë vit i kemi mbajtur 8 mbledhje që do të thotë se para çdo mbledhje të Kuvendit ka shtjelluar njëher pikat në KPF-ë. Pasi që e kemi marr edhe me material raportin dhe keni pasur kohë që ta lexoi, nese keni ndonjë vërejtje ose propozim urdhëroni.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket vendimeve si Kuvend nuk eshte e vertet se nuk është kthyer asnje vendim nga Ministria pasi që jemi deshmitar të gjithë se është kthyer një vendim kur e kemi bërë kalimin e mjeteve dhe ka qenë jo legjitime kur e kemi diskutuar buxhetin, si dhe sa i përket bashkpunimit ekzekutiv-legjislativ është e vertet se jemi duke e perjetuar pasi që është viti i katërt i mandatit, pothuajse është raporti i njëjt si i viti të kaluar vetem dashta me demnatu se është kthyer një vendim nga Ministria.

Kryesusi tha: cili është ai vendim dhe për cilin muaj bëhet fjalë?.

Xhejlane Behluli tha: konkretisht vendimi për bartjen e mjeteve për buxhet në shtator.

Kryesusi tha: ndoshta paska qenë ky vendim do ta kontrollojm.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: unë së pari mendoj se është mirë pasi që është respektu orari i raportimit nga Kryesuesi, çdo herë është e pamundur me u punu dhe mos me pas gabime, edhe pse kemi pasur debate e kundërshtime në mes të antarëve të Kuvendit përsëri kemi pasur harmoni nderetnike.

Xhejlane Behluli tha: harrove me permend edhe diçka andaj e kam një lutje që këtë vit propozimet tona rreth buxhetit, rreth projekteve të mirren parasysh dhe të propozohen për votim, lus që kur të bëjm propozime mos ti marmi me inate politike, e din shumë mirë se kam dhënë propozime por nuk jan përkrahur as sjan propozuar për votim.

Pika e tretë: Aprovimi i planit të punës së Kuvendit dhe orarit të mbajtjes së mbledhjeve për vitin 2021;

Kryesusi tha: ashtu si çdo vit tjetër qe e kemi aprovuar orarin e mbajtjes së mbledhjeve, edhe për këtë vit e kemi por këtë vit me propozim të Edmondit kemi pregadit edhe planin e punës, kemi pasur një takim për pregaditje të këtij plani, keni kohë që ta lexoni dhe nese keni ndonjë propozim ose ndryshim urdhëroni.

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: unë e kam marr vetem orarin e KPF-së.

Kryesusi tha: duhet të jet ndonjë gabim teknik, tash e shperndan asistentja edhe orarin e Kuvendit.

Ramush Mehmeti tha: sa i perket planit të punës është mirë dhe ka qenë detyr e Kuvendit së bashku me ekzekutivin që ta hartojnë planin e punës por fatkeqësishtë kjo ska ndodhë që tre vite por edhe ky plan i punës është i mangët pasi që në takim nuk kanë qenë përfaqësuesit nga ekzekutivi, ne e kemi punuar këtë plan të punës por sa do të zbatohet, në muajin janar e kemi pasur raportin e tremujorit të katërt financiar të vitit paraprak por ky raport nuk na ka ardh ndërsa sa i perket orarit të mbajtjes së mbledhjeve është mirë vetem duhet të aprovohet deri në muajin shtator, pasi që në shtator shperbëhet Kuvendi.

Kryesusi propozoi aprovimin e planit të punës dhe orarit pa tre muajt e fundit.

Më 11 vota për, 1 përmbajtur dhe 1 nuk ka votuar aprovohet plani i punës së Kuvendit për vitin 2021 nga anatërt prezent të Kuvendit dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET Planin e punës së Kuvendit për vitin 2021 të Komunës së Novobërdës.

Pika e katërt: Pruarja e vendimit për shitjen e automjeteve të vjetëra dhe të zhvlerësuar të Komunës së Novobërdës;

Kryesusi tha: kjo pikë ka ardhur propozim në mbledhje të KPF-së e propozuar nga Drejtori i Administratës Driton Abdyli andaj ja dha fjalën qe ta propozoj këtë pikë.

Driton Abdyli pasi pershendeti të pranishmit tha: në bazë të Ligjit për Vetqeverisje Lokale Komuna ka të drejt të posedoj pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, pasurin e luajtshme Komuna ka të drejt vetem të blej ndersa të paluajtshmen ka të drejt të blej dhe të shesë por për shitje duhet edhe vendim i Kuvendit.

Procesverbali i Kuvendit

Është fjala për shitjen e mjeteve të pashfrytëzuara dhe me defekte, ideja është që këto mjete të shiten përmes ankandit. Komuna jonë ka 20 automjete të pashfrytëzuara, andaj lus Kuvendit që të lejoj që të vazhdohen procedurat e mëtutjeshme, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: kësaj radhe kërkesa ka ardh me kry një formalitet pasi që nuk kemi material por nese është ai material para dy viteve dhe nese Kuvendi është për po, por duhet me pas bazë së për çka po mirret ai vendim se çka po qesim në shitje.

Xhejlane Behluli tha: sa i përket kësaj pike ka qenë edhe në KPF-ë dhe kemi diskutuar mjaftueshëm, Drejtori ka propozuar qe të formohet edhe një komision nga Kuvendi nese deshirojmë, është mirë me u përkrah.

Dobriroje Djordjevic tha: me këtë qështje jemi marrë edhe vitin e kaluar, është mirë të shiten ato automjete dhe të ndihmohen fëmijet e sëmurë ose dikush tjetër, është mirë të shiten ato mjete dhe mos të mirremi më me këto qështje.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: mendoj se sot duhet të kalohet kjo pikë të shiten ato vetura të blehen tjera, as Kryesusi nuk ka vetur zyrtare dhe nuk kan mundësi as materialet si të na dergojnë, besoj që është ide e mirë dhe është mirë që ta perkrahmi.

Pasi nuk pati tjera diskutime me 11 vota për, 2 nuk kan votuar aprovohet kjo pikë nga antarët prezent të Kuvendit dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET Vendimi për shitjen e atomjeteve të vjetëra dhe të zhvlersuara të Komunës së Novobërdës.

Pika e pestë: Të ndryshme;

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: siç e din për çdo vit Kuvendi Komunal ka marrë vendim për mbushje telefonike por këtë vit propozoj që mbushje ti ndahen edhe kryesuseses së Komitetit.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: unë kerkoj që për mbledhjen tjetër të ftohen OJQ dhe të tregojn se ku i kanë shpenzuar ato mjete që i kan perfituar.

Kryesuesi tha: e kemi në plan të punës këtë pikë.

Kryesuesi e hudhi në votim propozimin për mbushje telefonike, nga 20€ çdo muaj për Kryesuesin dhe zv.Kryesusin dhe nga 10€ për antarët e Kuvendit, zyrtaret që punojnë për kuvend dhe kryesusen e komitetit.

Me 12 vota për, 1 nuk ka votuar aprovohet nga antarët prezent të Kuvendit ky propozim dhe mirret ky:


VENDIM

APROVOHET vendimi për mbushje telefonike.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:45.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

